

Bashkësitë për Energji nga Burimet e Ripërtëritshme

Elena Qehaja

Konsulente e Re për Politika dhe Çështje Rregullative të Energjisë

Bashkësitë e Energjisë së Ripërtëritshme

Çfarë janë?

Entitete ligjore që u mundësojnë qytetarëve, bizneseve të vogla dhe autoriteteve lokale të bashkëpronësojnë dhe menaxhojnë projekte të energjisë së ripërtëritshme (RED II, 2018/2001).


Këto bashkësi qëllim themelor kanë plotësimin e nevojave të konsumit vetanak të anëtarëve ose aksionarëve të saj, si dhe kontributin në përmirësim mjedisor dhe në dobi sociale të anëtarëve ose aksionarëve të saj.

- Promovojnë zgjidhje energjetike të bazuara në komunitet
- Anëtarët prodhojnë, konsumojnë dhe ndajnë energjinë në nivel lokal
- Ulin varësinë nga sistemet e centralizuara

Referencat: RED II, 2018/2001, LIGJI NR. 08/L-258

Përfitimet e BER për Individët

- Kursime të Kostove përmes Fuqisë Blerëse Kolektive
- Gjenerim të të Ardhurave nga Investimet në Energji të Rinovueshme
- Rritje e Efiçencës së Energjisë
- Ulja e Gjurmës së Karbonit
- Përmirësimi i Cilësisë së Ajrit dhe Ujit



Rëndësia e Bashkësive të Energjisë së Ripërtëritshme

Rëndësia e BER qëndron në aftësinë e tyre për të:

- ☐ Përsheptuar tranzicionin energjetik
- ☐ Fuqizuar qytetarët që të marrin pjesë aktivisht në tregjet e energjisë
- ☐ Demokratizuar sistemet energjetike
- ☐ BER adresojnë sfida sociale, ekonomike dhe mjedisore

Referenca: Komisioni Evropian, RED II Directive 2018/2001



Co-funded by
the European Union



Objektivat e Bashkësive të Energjisë



UNIVERSITÀ
POLITECNICA
DELLE MARCHE

Comparative
Research
Network:



balkan
green
foundation



Promovimi i Tranzicionit Energjetik dhe Objektive Klimatike

BER luajnë një rol kyç në arritjen e objektivave të BE-së për neutralitetin klimatik deri në vitin 2050, siç përcaktohet në Marrëveshjen e Gjelbër Europiane.

Kontributi i BER:

- **Ulja e varësisë nga lëndët djegëse fosile.**
- **Mbështetja e objektivit të BE-së për redukimin e emetimeve 55% deri në vitin 2030.**
- **Rritja e rezistencës lokale ndaj ndërprerjeve të furnizimit me energji.**



Prodhimi dhe Konsumi Lokal i Energjisë

BER fuqizojnë komunitetet për të arritur autonomi energjetike lokale, duke reduktuar varësinë nga importet e jashtme dhe rrjetet e centralizuara.

Përmes prodhimit, ruajtjes dhe shpërndarjes lokale të energjisë së ripërtëritshme, BER sigurojnë një furnizim të qëndrueshëm dhe të përbalueshëm me energji.

Përfitimet kryesore:

- **Siguria energjetike**
- **Fleksibiliteti**
- **Qëndrueshmëria**

Prodhimi dhe Konsumi Lokal i Energjisë

Rasti Studimor: Samsø - Bashkësia e Ishullit



Komuna e ishullit Samsø në Danimarkë ka transformuar plotësisht sistemin e saj energjetik, duke kaluar nga lëndët djegëse fosile në energji të ripërtëritshme, duke u bërë ishulli i parë në botë me energji 100% të pastër.

Rezultatet kryesore të arritura:

- Neutralitet karbonik
- 100% pronësi lokale mbi investimet në energjinë e ripërtëritshme.
- Përfitime të mëdha socio-ekonomike nga tranzicioni energjetik.

Reference: <https://unfccc.int/climate-action/un-global-climate-action-awards/climate-leaders/samsø>

Prodhimi dhe Konsumi Lokal i Energjisë

Rasti Studimor: Samsø - Bashkësia e Ishullit

Emetimet vjetore të CO₂ pothuajse zero.

100% energji e ripërtëritshme – Investime në:

- 11 turbina ere në tokë & 10 në det
- 4 termocentrale me biomasë
- Panele diellore & automjete elektrike

Synimi për vitin 2030:

- Zero karburante fosile
- Zgjerimi i energjisë së pastër në:
 - Ngrohje & transport rrugor
 - Lëvizje detare me biogaz ose energji elektrike lokale



Reference: <https://unfccc.int/climate-action/un-global-climate-action-awards/climate-leaders/samsø>

Përfitimet Ekonomike dhe Krijimi i Vendeve të Punës

Krijimi i vendeve të punës në:

- Instalimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së energjisë së ripërtëritshme.
- Operimin dhe menaxhimin e sistemeve energjetike.

Kursime në kosto

Investime lokale

BER tërheqin **investime në teknologji të pastra, fuqizojnë bizneset e vogla dhe mbështesin ekonominë e qëndrueshme rurale & urbane.**



Përprojekja kundër Varfërisë Energjetike

Varfëria energjetike prek miliona njerëz në Evropë. BER ofrojnë zgjidhje duke:

- Siguruar energji me çmime të përballueshme për familjet në nevojë përmes blerjes kolektive & shpërndarjes së energjisë.
- Ulur kostot e energjisë përmes prodhimit të energjisë së ripërtëritshme lokale.
- Garantuar akses të qëndrueshëm në energji, veçanërisht në zonat e nënpërfaqësuar.

Luftimi i Varfërisë Energjetike - Shembuj nga Spanja

Bashkësia Energjetike në Rubí, Barcelona

Iniciativë e këshillit bashkiak për shpërndarjen e energjisë nga instalimet fotovoltaike publike. Mbështet pjesëmarrësit duke mbuluar deri në 35% të konsumit të tyre të energjisë.

Som Energia – Kooperativa Pioniere

Ka ndihmuar mijëra qytetarë në Spanjë të prodhojnë & konsumojnë 100% energji të ripërtëritshme. Fokus te projektet kolektive fotovoltaike dhe me erë.

Lagjja Diellore e Zaragozës

Banorët & bizneset e vogla ndajnë energjinë e prodhuar nga panelet diellore mbi ndërtesat publike. Ulje e faturave të energjisë & forcim i kohezionit social.

Reference: <https://nordy.es/en/market-news/the-future-of-energy-communities>

Integrimi i Inovacionit dhe Teknologjive Inteligjente

BER shfrytëzojnë teknologjitë e avancuara për të rritur eficiencën dhe menaxhimin e energjisë:

Rrjetet Inteligjente (Smart Grids) – Lehtësojnë shpërndarjen dhe monitorimin e konsumit të energjisë.

Sistemet e Ruajtjes së Energjisë – Bateritë sigurojnë energji gjatë kërkesës së lartë.


Platformat e Tregtimit Peer-to-Peer – Lejojnë qytetarët të shesin energjinë e tepërt brenda rrjetit

Integrimi i mjeteve digjitale rrit fleksibilitetin & besueshmërinë e sistemeve energjetike

Integrimi i Inovacionit dhe Teknologjive Inteligjente

Si funksionon Tregtimi i Energjisë P2P?

- Platforma e tregimit P2P mundëson shkëmbimin e energjisë direkt mes individëve.
- Prosumatorët shesin tepriçën e energjisë tek të tjerët pa kaluar përmes furnizuesit qendror.
- Model i decentralizuar – Më shumë pavarësi & transparencë në tregun e energjisë.





Co-funded by
the European Union



Shembuj nga Greqia



UNIVERSITÀ
POLITECNICA
DELLE MARCHE

Comparative
Research
Network:




balkan
green
foundation



Bashkësia e Energjisë Hyperion

- Bazuar në Athinë
- Jo fitimprurës
- 128 anëtarë
- Sfonde të ndryshme
- Park solar 500kW

HYPERION
SOLAR COMMUNITY



Referenca: <https://hyperion-community.gr/en/>

Bashkësia e Energjisë Hyperion

- Hyperion çdo muaj dhuron 5% të energjisë elektrike të prodhuar për familjet në nevojë dhe organizatat e solidaritetit.
- 10 familje në nevojë (nga 3 Komuna të ndryshme)
- 1 qendër kulturore për komunitetet afrikane - Anasa
- 1 kuzhinë sociale - Mano Aperta

HYPERION
SOLAR COMMUNITY



Referenca: <https://hyperion-community.gr/en/>

Bashkësia e Energjisë Minoan

- Themelimi: 9 Tetor 2019 në qytetin e vogël Arkalochori.
- Anëtarët: 1.300 anëtarë, me 13 Komuna dhe Autoritetin Rajonal të Kretës.
- Qëllimi: Të marrë një rol thelbësor dhe udhëheqës në një tranzicion energjetik të drejtë, racional dhe demokratik në Kretë
- Energji elektrike falas për 50 familje me të ardhura të ulëta, viktima të tërmetit.



Referenca: <https://minoanenergy.com/en/>



Co-funded by
the European Union



Situata në Kosovë



UNIVERSITÀ
POLITECNICA
DELLE MARCHE

Comparative
Research
Network:



balkan
green
foundation



Korniza Ligjore dhe Politike për BER në Kosovë

Legjislacioni Ekzistues: Ligji për Promovinin e Përdorimit të Energjisë nga Burimet e Energjisë së Ripërtëritshme, i miratuar në vitin 2024, në përputhje me direktivat e BE-së

Përputhshmëria me BE-në: Përpyqje për harmonizim me Direktivën për Energjinë e Ripërtëritshme II për të lehtësuar zhvillimin e BER

Boshllëqet e Identifikuara: Nevoja për legjislacion sekondar për të operacionalizuar plotësisht BER dhe për të ofruar udhëzime të qarta

Pengesat Strukturore për Zhvillimin e Bashkësive të Energjisë së Ripërtëritshme në Kosovë

Infrastrukturë e Vjetruar

Rrjeti energjetik ekzistues është i vjetëruar dhe pengon integrimin e burimeve të decentralizuara të energjisë

Kufizime Financiare

Qasja e kufizuar në financim dhe mungesa e stimuljeve financiarë për projekte të udhëhequra nga komuniteti

Mungesë e Ekspertizës Lokale

Ka mungesë të ekspertëve vendorë në teknologjitë e energjisë së ripërtëritshme

Rekomandime për Themelimin e BER në Kosovë

Hartimi dhe miratimi i ligjeve specifike që mbështesin formimin dhe funksionimin e BER

Stimuj Financiarë

Ofrimi i subvencioneve, lehtësimeve tatimore dhe qasjes në kredi me interes të ulët për bashkësitë energjetike

Bashkëpunim Ndërsektorial

Nxitja e bashkëpunimit lokal, rajonal, qeveritar, ndërkombëtar dhe ndërmjet OJQ-ve për zhvillimin e BER

Kalimi drejt energjisë së qëndrueshme fillon në nivel lokal

Faleminderit për Vëmendjen!



Co-funded by
the European Union

Financuar nga Bashkimi Evropian. Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura janë megjithatë vetëm ato të autorit(ve) dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Bashkimit Evropian ose të Agjencisë Ekzekutive Evropiane të Arsimit dhe Kulturës (EACEA). As Bashkimi Evropian dhe as EACEA nuk mund të mbajnë përgjegjësi për to.